



Projekti METOIKOS

Migracioni Ciklik dhe Integrimi Udhëzues i Shkurtër për Politikbërësit

Anna Triandafyllidou
European University Institute

Me kontributin e Ayse Caglar, Camilla Devitt, Krystyna Iglicka, Katarzyna Gmaj, Carmen Gonzalez- Enriquez, Nick Mai, Thanos Maroukis



EUROPEAN UNIVERSITY INSTITUTE, FLORENCE
ROBERT SCHUMAN CENTRE FOR ADVANCED STUDIES

**Migracioni Ciklik dhe Integrimi
Udhëzues i shkurtër për politikbërësit**

ANNA TRIANDAFYLLIDOU
EUROPEAN UNIVERSITY INSTITUTE

ME KONTRIBUTIN E AYSE CAGLAR, CAMILLA DEVITT,
KRYSTYNA IGLICKA, KATARZYNA GMAJ, CARMEN
GONZALEZ ENRIQUEZ, NICK MAI, THANOS MAROUKIS

PROJEKTI METOIKOS

Ky tekst mund të shkarkohet nga interneti vetëm për qëllime kërkimo-studimore private.
Riprodhimi i këtij teksti, i printuar apo në kopje elektronike, për qëllime të tjera kërkon lejen e
autorit(-ëve), botuesit(-ëve).
Nëse pjesë të materialit citohen, duhet të referohet emri i plotë i autorit(ëve), botuesit(ëve), titulli,
numri i faqes, viti i botimit dhe shtëpia botuese.

© 2011 Anna Triandafyllidou
Printuar në Itali
European University Institute
Badia Fiesolana
I – 50014 San Domenico di Fiesole (FI)
Italy
www.eui.eu/RSCAS/Publications/
www.eui.eu
cadmus.eui.eu

Projekti kërkimor METOIKOS

Shembuj të migracionit ciklik në Evropën Jugore dhe Qëndro-lindore: nevojat dhe mundësitë për migrantët dhe politikbërësit

Projekti METOIKOS trajton shembuj të migracionin ciklik në tre rajone të Evropës: në Evropën Jug-lindore dhe në Ballkan (Greqi, Itali, Shqipëri); në Evropën Jug-perëndimore dhe në Magreb (Spanjë, Itali, Marok); dhe në Evropën Qëndro-lindore (Poloni, Hungari dhe Ukrainë). METOIKOS, studion në veçanti lidhjen midis llojeve të ndryshme të migracionit ciklik dhe procesit të integritimit (në vendin e destinacionit) dhe të ri-integritimit (në vendin e prejardhjes). Identifikon sfidat kryesore dhe shanset e përfshira në migracionin ciklik si për vendet e prejardhjes ashtu edhe për ato të destinacionit, dhe vetë migrantët (dhe familjet e tyre) duke zhvilluar paralelisht mjete të reja konceptuale çka do të shërbejnë për të analizuar migracionin ciklik dhe integritimin. Projekti do të prodhojë politika rekomanduese (një Guidë për hartuesit e politikave, e disponueshme në 10 gjuhë evropiane), për krijuesit e politikave lokale, rajonale dhe nacionale në lidhje me strukturimin e migracionit ciklik në përshtatshmëri me politikën (ri-)integruese. Gjithashtu do të organizojë tre workshop-e rajonale (në Spanjë, Itali dhe Marok; në Greqi Itali dhe Shqipëri; dhe në Poloni, Hungari dhe Ukrainë). Së fundi, projekti do të promovojë diskutime online mbi migracionin ciklik me qëllim që të rrisë ndërgjegjësimin mbi sfidat dhe avantazhet e lëvizjeve ciklike si në vendet e B.E. ashtu dhe të fqinjëve (EU Neighbourhood), dhe të rajonit Euro-Mesdhetar.

Projekti bashke-sponsorizohet nga European Integration Fund for Third Country Nationals, Community Actions 20008.

Projekti METOIKOS administrohet nga qendra Robert Schuman Centre for Advanced Studies dhe koordinohet nga Prof. Anna Triandafyllidou (anna.triandafyllidou@eui.eu).

EUI dhe RSCAS nuk janë përgjegjes për opinionet e shprehura nga autori(-ët)

Robert Schuman Centre for Advanced Studies (RSCAS) është qënder studimore për programe të avancuara post-doktorale dhe që nga Shtatori i vitit 2006 drejtohet nga Stefano Bartolini. E themeluar në vitin 1992, qëllimi saj është të zhvillojë studime/kërkime ndër-disiplinore dhe krahasuese mbi tema të rëndësishme që lidhen me procesin e integritimit dhe shoqërisë Evropiane. RSCAS administron programe dhe projekte të mëdha kërkimore, një game të gjërë të grupeve të punës (working groups) dhe të iniciativave ad hoc. Axhenda kërkimore është e organizuar rreth një bërthame temash kryesore dhe evolon vazhdueshmërisht duke reflektuar ndryshimet në axhendën e integritimit evropian dhe zgjerimit të anëtarësimit në B.E. Një ndër temat e saj kryesore është Migracioni.

Anna Triandafyllidou është profesoreshë (part-time) në RSCAS, EUI, në Firence dhe Studiuese e Parë (Senior Research Fellow) në Fondacionin Grek për Politikën Evropiane dhe Politikën e Jashtme - ELIAMEP në Athinë. Ajo është Koordinatorë Shkencore e projektit METOIKOS. Fushat e saj kryesore të studimit/kërkimit dhe ekspertizës janë migracioni, nacionalizmi dhe integritimi Evropian. Që nga vitit 2002, ajo jep mësim në Kolegjin Evropian në Bruges, Belgjikë si pedagoge vizitore. Botimet e saj të fundit përmbledhin: *European Multiculturalism(s)* (with T. Modood and N. Meer, 2011, Edinburgh University Press), *What is Europe?* (with R. Gropas, 2012, Palgrave), *Migrant Smuggling. Irregular Migration from Africa and Asia to Europe* (with T. Maroukis, 2012, Palgrave)

Për më tepër informacione:

Robert Schuman Centre for Advanced Studies

European University Institute

Via delle Fontanelle, 19

50016 San Domenico di Fiesole (FI), Italy

Fax: + 39 055 4685 770

E-mail: anna.triandafyllidou@eui.eu

<http://www.eui.eu/RSCAS/>

Pse studiojmë migracionin ciklik

Termi migracioni ciklik është bërë një term citat (buzzword) midis qarqeve politike dhe akademike Evropiane që nga viti 2007 kur Komisioni Evropian publikoi një Komunikatë mbi Partneritetet Qarkulluese dhe Migracionin Ciklik (Communication on Mobility Partnerships and Circular Migration). Në këtë dokument theksohen avantazhet dhe sfidat e migracionit ciklik dhe promovohen ide politike specifike për implementimin e tij. Mjaft politikbërës nacional dhe të B.E. e kanë prezantuar idenë e migracionit «ciklik» me mjaft entuziazëm si një fitore politike e trefishtë që presupozon të adresojë njëherazi mungesat në tregun e punës - duke siguruar në kohë dhe me fleksibilitet fuqi punëtore migratore sipas kërkesës, dhe përballjen me sfidat integruese të migrantëve pasi migrantët ciklik nuk kanë ardhur për të qëndruar dhe përpos sfidat e integritit të tyre social janë shumë të kufizuara në mos jo-ekzistente. Për më tepër, migracioni ciklik është parë si një strategji për shmangjen e migrimit të “trurit” dhe një mjet për promovimin e qarkullimit apo ciklimit të tij.

METOIKOS është projekti i parë që studion empirikisht migracionin ciklik nëpërmjet studimeve të rastit (case studies) ndër-nacionale krahasuese, duke kërkuar kështu të ndërtojë një tipologji të migracionit ciklik dhe të zbulojë faktorët ndikues si dhe rolin e politikave në pengimin apo nxitjen e tij.

Metodologjia

Projekti METOIKOS ka studiuar migracionin ciklik në terren përmes kërkimit empirik të zgjeruar (10-15 intervista me politikbërësit dhe 30-50 intervista me migrantët ciklik në çdo vend, rishikimin e statistikave përkatëse, të dokumentave politikë, dhe të literaturës akademike) në gjashtë çifte vendesh midis të cilëve migracioni ciklik ndodh dhe përbën një realitet. Këto vende janë:

- Itali-Shqipëri dhe Greqi-Shqipëri,
- Itali-Marok dhe Spanjë-Marok,
- Hungari-Ukrainë dhe Poloni-Ukrainë.

Ky Udhëzues i shkurtër përmbledh gjetjet tona kryesore studimore të cilat janë të dobishme për punën e Politikbërësve në lidhje me migracionin ciklik. Ne prezantojmë rekomandime speciale për politikbërësit e BE dhe ato nacional duke i sugjeruar mënyra për lehtësimin e lëvizjeve ciklike por duke siguruar njëkohësisht mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, ruajtjen e legjitimitetit dhe kthimin e migracionit ciklik në benefit për të gjitha palët e përfshira.

Përkufizimet

Migracioni ciklik për qëllim të këtij studimi është përkufizuar si migracion **internacional, i përkohshëm dhe përsëritës për arsye ekonomike. Tipologjia e migracionit ciklik** duhet marrë parasysh të paktën tre dimensione:

- Së pari, natyra e rregullt ose e parregullt e lëvizjeve ciklike – dhe përpos karakteri i rregullt ose i parregullt i këtij fenomeni.
- Së dyti, niveli i aftësive dhe ai arsimor i njerëzve të përfshirë në të (me kualifikim të ulët ose gjysëm të ulët kundrejt kualifikimit të lartë) dhe,
- së treti, harku kohor i çdo qëndrimi dhe kthimi (lëvizje ciklike afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë).

Tipologjia e Migracionit Ciklik

Ne kemi konstatuar tre tipa kryesore të **migracionit të ligjshëm ciklik**:

1. **Migracioni i ligjshëm sezonal për arsye punësimi (migrantë me banim në vendin e origjinës) – spontan ose i rregullt**

Kryesisht në sektorin e agrokulturës, i rregulluar nga marrëveshje bilaterale midis vendeve anëtare të B.E. dhe vendeve specifike të origjinës dhe/ose nga leje të veçanta qëndrimi. Ato mund të marrin formën e programeve të organizuara (sikurse midis Marokut dhe Spanjës) ose të dispozitave të përgjithëshme për migracionin sezonal (sikurse midis Shqipërisë dhe Greqisë). Qëndrimi sezonal nuk mund të tejkalojë harkun kohor prej gjashtë muajsh dhe normalisht lejet e punësimit janë vetëm për një sektor dhe për një punëdhënës. Por ky tip migracioni mund të rregullohet dhe mbi bazën e një vize speciale afat-shkurtër.

2. **Migracioni i ligjshëm ciklik për arsye punësimi (migrantë banues në vendin e origjinës) - spontan**

Persona të kualifikuar ose afaristë. Njerëzit mund të qarkullojnë midis ty shteteve duke disponuar një leje qëndrimi (me afat të pa përcaktuar) ose një pasaportë apo kartë identiteti (si p.sh. homogjenët sikurse janë grekët etnik të Shqipërisë në Greqi) që i japin mundësinë të lëvizin lirshëm. Ata kanë tendencë të qëndrojnë disa javë ose muaj në secilin shtet (atë të origjinës dhe atë të destinacionit) për shkak të natyrës së punës së tyre (p.sh. ekspertë IT, ekonomistë) ose pasi janë afaristë dhe kanë alteruar biznesin midis dy shteteve, ose për shkak se zotërojnë dy punë me kohë të pjesëshme në secilin prej shteteve (p.sh. një doktor Ukrainas dhe një akademik ukrainas i punësuar në Ukrainë dhe Poloni).

Ndoshta kjo është kategoria e lëvizjeve të përkohëshme të përsëritura, e cila është më afër asaj çka është përshkruar si migracion ciklik në Komunikatën e Komisionit Europian në Maj të 2007.

3. **Migracioni ciklik i ligjshëm për punësim (migrantët me banim në vendin e destinacionit) - spontan**

Njerëz me aftësi të mesë ose të ulëta të cilët janë migrant afatgjatë në vendin e destinacionit por kalojnë vështirësi për të gjetur punë në këtë periudhë (p.sh. për shkak të krizës ekzistuese ekonomike) ose janë pjesërisht të punësuar (kanë punë të përkohëshme ose të pa stabilizuar). Këto njerëz qarkullojnë midis vendeve të migrimit dhe atyre të origjinës për:

- tu kujdesur për mirëmbajtjen e shtëpisë
- të kryer punë në fermë

Përveç kësaj, këtu dallojmë dy tipe **gjysëm të ligjshme të migracionit ciklik**:

4. **Migracioni ciklik gjysëm i ligjshëm për punësim (migrantë me banim në vendin e origjinës) – i cili mund të ndjekë një model sezonal punësimi ose jo, ku qëndrimi është i ligjshëm por punësimi informal.** Sektorët e punësimit variojnë duke përfshirë këtu ndërtimin, shërbimet shtëpiake, turizmin dhe hotelerinë. Ky tip i migracionit ciklik është teknikisht i ligjshëm pasi hyrja dhe qëndrimi i migrantëve kryhet me:

- vizë turistike të zonës Schengen,

- me një vizë speciale afat-shkurtër në disa vende anëtare të B.E. (p.sh. për Ukrainasit në Poloni),
- një vizë nacionale speciale (p.sh. për Hungarezët etnikë të cilët janë shtetas Ukrainas në Hungari),
- një dokument prë kalimin e kufirit (p.sh. për Ukrainasit në Hungari),

Por punësimi i saj/tij është i parregullt dhe viza e tij/saj nuk i jep të drejtën e punësimit.

Personat e përfshirë janë gjysëm të kualifikuar ose me kualifikim të lartë por janë të pa punë dhe/ose nuk plotësojnë nevojat e mbijetesës në vendin e origjinës dhe për arsye të ndryshme (për arsye familjare ose thjesht për pamundësinë e lëvizjes/udhëtimit të ligjshëm) nuk duan të migrojnë për një kohë më të gjatë. Ato përfitojnë nga ekzistenca e rrjeteve etnike (si p.sh. Poloni-Ukrainë ose Hungari-Ukrainë) dhe inkuadrohen në migracionit ciklik. Ata zakonisht punësohen në sektorët e pastrimit dhe shërbimeve kujdestare (gratë) ose të ndërtimit dhe bujqësisë (burrat).

5. **Migrimi ciklik gjysëm i ligjshëm për punësim (migrantë me banim në vendin e destinacionit) – spontan.**

Personat e përfshirë kanë kualifikim të ulët ose të mesëm dhe janë me qëndrim të përhershëm në vendet e destinacionit por përballojnë vështirësi për të gjetur punë në këtë periudhë (p.sh. për shkak të krizës aktuale ekonomike) ose janë pjesërisht të punësuar (kanë punë të përkohshme ose të paqëndrueshme).

Këto persona përfshihen në migrimin ciklik midis dy shteteve me qëllim që të:

- Bëjnë biznes të vogël, blejnë materiale zakonisht nga vendi i destinacionit dhe i shesin ato në vendin e origjinës. Ky biznes është informal e pa licensë.
- Ofrojnë shërbime transporti tek bashkëkombësit e tyre (transportojnë të mirat materiale që ata zotërojnë nga vend i destinacionit drejt vendit të origjinës). Ky është gjithashtu një shërbim i ofruar pa licensën përkatëse.

Në të dyja këto raste, oficerët e doganave në vendeve të përfshira (si p.sh. në Itali dhe Marok apo si në Shqipëri dhe Greqi) mund ti kërkojnë migrantëve ciklik të paguajnë gjoba ose t'ju japin rryshfete/para nën dorë për ti lënë ata të kalojnë mallin.

I fundit por jo më pak i rëndësishëm është dhe **migracioni ciklik i parregullt:**

6. **Migracioni ciklik i parregullt:** Migrantët hyjnë pa dokumentacionin përkatës dhe punësohen në tregun informal sezonal ose të përkohshëm të punës në sektorët e agrokulturës, hotelerisë, turizmit, pastrimit dhe përkujdesjes shtëpiake. Këto janë sektorë ku zakonisht edhe punëtorët vendas punojnë në mënyrë informale.

Roli i politikave në nxitjen e migracionit ciklik

Nga të gjashtë tipat e migracionit ciklik të identifikuar më lartë:

- **pothuajse të gjithë janë spontanë,**
- **burojnë nga nevojat ekonomike,**
- janë të mundësuar nga **kapitali social i migrantëve** (p.sh. përfshirja e tyre në rrjete informale dhe njohja e të dy vendeve – e destinacionit dhe origjinës)

Ato konsiderohen të ligjshëm nga momenti që migrantët janë të pajisur me leje qëndrimi afatgjata të llojeve të ndryshme ose janë gjysëm të ligjshëm nëse migrantët përfitojnë nga politika specifike nacionale nëpërmjet pajisjes me viza speciale që e bëjnë të ligjshëm qëndrimin por jo punësimin apo ushtrimin e aktivitete të tjera ekonomike.

Interesant është fakti se disa nga këto tipe të migracionit ciklik të ligjshëm ose gjysëm të ligjshëm janë të karakterit sezonal. **Duket se në të vërtetë ekzistojnë hapësirë dhe shanse për migracionin dhe ciklik dhe punësimin në sektorë të ndryshëm të cilët i përgjigjen nevojave ekonomike të migrantëve.** Janë më të rralla rastet kur qarkullimi/migrimi ciklik shoqërohet nga dëshira për të zhvilluar karrierë ose për të përmirësuar pozicionin profesional në vendin e origjinës apo në atë të destinacionit. Këto janë migrantë ciklik me kualifikim të lartë, të cilët edhe pse paraqesin mjaft interes përbëjnë një pakicë të vogël.

Roli i politikave është vendimtar përsa i përket lejimit të qarkullimit/lëvizjes së lirë të migrantëve. Kështu ne vërejmë se qarkullimi ciklik është i mundur kur:

- migrantët disponojnë karta identiteti ose leje qëndrimi të cilat lejojnë qarkullimin dhe punësimin në të dyja vendet.
- migrantët kanë akses në pajisjen me dokumenta qëndrimi që i japin mundësinë të udhëtojnë lirshëm edhe kur i duhet të punojnë në informalitet.

Kur migrantët ndodhen përballë rrezikut ose së kapjes në kufi për kalim të paligjshëm ose të humbjes së lejen së përkohshme të qëndrimit në vendin e destinacionit, nuk lëvizin duke ju shmangur kësaj përfshirjes në migracion ciklik.

Përbën migracioni ciklik një situatë trefish fituese?

Përgjithësisht, migracioni ciklik nuk është një alternative e preferuar për migrantët dhe familjet e tyre. Migrantët do të preferonin më mirë të qëndronin në një nga të dy vendet. Por, nga njëra anë ata nuk mund të qëndrojnë në vendin e origjinës sepse nuk kanë mundësi të mjaftueshme mbijetesë dhe/ose për të siguruar një jetë më të mirë si për veten ashtu dhe për fëmijët e tyre. Nga ana tjetër, migrimi i tyre nuk është afatgjatë pasi ky variant ose nuk përbën një alternative reale të arritshme për to (mos ekzistenca e kanaleve ligjore për migracion ekonomik afatgjatë) ose sepse ata (në mënyrë të veçantë femrat) kanë detyrime familjare ndaj familjes (fëmijë të vegjël ose adoleshent, prindër të moshuar) dhe nuk kanë mundësi të qëndrojnë larg për një kohë të gjatë. Gjithashtu, ato mund të përfshihen në migracionin ciklik në rastin kur të ndodhur me banim në vendin e destinacionit (por shumë më rrallë) gjenden në situatë papunësie ose pjesërisht të punësuar.

Kësisoj, migracioni ciklik ofron përfitime të moderuara ekonomike **për migrantin ciklik dhe familjen e tij/të saj**. Ai kryesisht përbën një mjet mbijetese dhe një mënyrë për të përmissuar kushtet e jetesës dhe perspektivat për të ardhmen e fëmijëve të tyre.

Rezultatet/gjetjet e projektit METOIKOS tregojnë se nuk ekzistojnë **përfitime të tjera të kapitalit social me përjashtim të kategorisë të migrantëve ciklik me kualifikim të lartë** (qarkullimi i trurit), ku gjithësesi janë përfshirë një numër i vogël njerëzish që kryesisht merren me biznes, tregti ose që zhvillojnë projekte midis dy vendeve. Shumica e migrantëve ciklik janë të përfshirë në sektorë që kërkojnë kualifikim dhe paga të ulta (në bujqësi, në ndërtim, në sektorin e pastrimit dhe të përkujdesjes shtëpiake, shitës rrugësh ose tregti të vogla). Ata nuk kryejnë asnjë kualifikim në vendin e destinacionit. Ata nuk ndjekin asnjë kurs trajnimit dhe nuk kanë mësuar as gjuhën e vendit të destinacionit (me përjashtim të programit Spanjo-Maroken për punësimin sezonal). Në të kundërt, disa (p.sh. gratë Ukrainase në Poloni) përballen me problemin serioz të humbjes së aftësive pasi ato mund të kenë diploma universiteti dhe përfundojnë të punojnë në sektorin e shërbimeve ose përkujdesjes shtëpiake.

Migracioni ciklik mbart anë **negative në nivel personal** nga moment që migranti është ndarë nga fëmijët e tij. Mungesa e vazhdueshme dhe e përsëritur e prindërve mund të ndikojë në mirëqënien emocionale të fëmijëve akoma dhe kur ata janë lënë me familjarë të afërt (gjyshërit, hallë/xhajë). Për më tepër, migrant ndjehet i huaj në të dy vende duke qëndruar si pasojë diku mes të të dy vendeve.

Migracioni ciklik përfshin përfitime të moderuara për vendin e origjinës:

Vendi i origjinës ka më pak njerëz të pa punë dhe përfitime nga remitancat modeste të migrantëve ciklik. Këto remitanca nuk janë mjaft të larta por gjithsesi ato kontribuojnë rëndësishëm në zhvillimin socio-ekonomik të vendit të origjinës, pasi migrati ciklik qendron vetëm disa muaj në vit në vendin e destinacionit, për pasojë të ardhurat e tij janë aq sa për të siguruar mbijetesën në shtëpi.

Asnjë nga vendet e origjinës të studiuara (Shqipëria, Maroku, Ukraina) nuk kanë implementuar ndonjë politikë për ri-integrimin e migrantëve ciklik. Si pasojë edhe kur ekziston potencial për të zhvilluar biznes, tregti të vogël, apo për të prurë eksperiencë apo kontaktet nga jashtë (kapitalin social të migrantëve ciklik), kjo nuk mund të sjelli frute pasi mungojnë kushtet bazë: niveli i lartë i korrupsionit, infrastruktura e varfër dhe paqëndrueshmëria e ekonomisë nacionale mund të vejnë në rrezik çdo investim.

Ri-integrimi social-ekonomik i migrantëve ciklik në vendin e origjinës mund të jetë jo problematik nëse migrantët kanë qëndruar jashtë shtetit për një kohë të shkurtër dhe familjet e tyre ndodhen në vendin e origjinës. Në çdo rast, vështirësitë apo problemet e krijuara përballohen nga familja dhe miqtë dhe jo nga politikat shtetërore.

Vend i destinacionit/qëndrimit përfiton nga migracioni ciklik në dy mënyra specifike:

- Ai plotëson nevojat specifike të tregut të punës në sektorë ku vendasit nuk duan të punojnë sepse natyra e punës është e perkoshme dhe sezonale, puna është e vështirë dhe me pagesë dhe prestigj të ulët.
- Nuk ka nevojë të shqetësohet për temat e integrimit social të migrantëve ciklik dhe familjeve të tyre sepse ose migrantët ciklik dhe familjet e tyre janë të vendosur në vendin e destinacionit dhe të integruar mirë prej vitesh ose familja është në vendin e origjinës.

Vend i destinacionit përballon dy pengesa të rëndësishme në lidhje me migracionin ciklik:

- Ai nuk mund të kontrollojë nëse migrantët ciklik shkelin kushtet e qëndrimit të tyre: p.sh. ata punojnë në sektorë ose rajone të ndryshëm nga ato që fillimisht ishin aprovuar.

- Kjo formë e migracionit nuk kontribuon në zgjidhjen e defiçitit demografik pasi migrantët janë ciklik dhe eventualisht kthehen në vendin e tyre.

Qasja politike e B.E. ndaj Migracionit Ciklik: Partneritetet e Lëvizshmërisë

Megjithëse realiteti i migracionit ciklik ka ekzistuar për një kohë të gjatë në Evropë, termi 'migracioni ciklik' është futur në dikursin politik pas publikimit të *Migracioni Ciklik dhe partneritetet e lëvizshmërisë midis Bashkimit Evropian dhe vendeve të treta* [COM \(2007\) 248 final](#) në Maj 2007.

Qëllimi i kësaj Komunikate ishte të promovonte kanalet e migracionin legal për punëtorët e vendeve të treta për punësim në B.E., kryesisht nëpërmjet skemave të migracionit ciklik dhe të përkohshëm por ashtu edhe nëpërmjet të ashtëquajturave partneritete të lëvizshmërisë.

Partneritetet e lëvizshmërisë (Mobility partnerships) janë skema legale që mund të kornizojnë migracionin e ligjshëm - mundësisht të një karakteri ciklik ose të përkohshëm - në një kontekst më të gjërë të politikës së migracioni midis një numër vendesh anëtare të B.E. (ato që dëshirojnë t'i bashkangjiten këtij lloj partneriteti) dhe një vendi të tretë (ose më shumë vendeve të treta) .

Ndërsa Komunikata sqaron se partneritetet e lëvizshmërisë do të marrin forma të ndryshme dhe do të varen nga situata specifike, një listë e gjatë angazhimesh që priten të plotësohen nga vendet e treta janë të rreshtuara gjithashtu në Komunikatë (f.4). Këto angazhime janë të lidhura me ripranimin e shtetasve të tyre si dhe shtetasve të vendeve të treta, me përpjekjet për përmirësimin e kontrollit të kufijve dhe të sigurimit të dokumenteve të udhëtimit, me bashkëpunimin me B.E. në temat e menaxhimit të kufijve dhe marrjen e masave konkrete në luftën kundër trafikimit dhe kontrabandës së qënieve njerëzore.

Një angazhim i fundi, i shtuar gjithashtu, lidhet me detyrimin e vendit të tretë të promovojë 'punësimin produktiv dhe punën modeste' si një masë, që ndërmjet të tjerave, do të reduktojë stimujt e nxitjes së migracionit të paligjshëm. Për më tepër, theksohet se angazhimet e mësipërme duhet të implementohen me respekt të plotë ndaj të drejtave të njeriut. Duke lexuar këtë listë dikush mund të pyesi habitshëm se cila nga vendet e treta në fqinjërinë e Evropës Lindore dhe Jugore disponon kapacitete të afta për të përmbushur këto angazhime. Me fjalë të tjera, këto angazhime mund të jenë të dëshirueshme por jo realiste.

Kështu, deri tani Komisioni Evropian e ka parë **migracionin ciklik si pjesë ose paketë e këtyre partneriteteve të lëvizshmërisë**. Komunikimi vën re se migracioni ciklik është potencialisht i dobishëm si për B.E. sepse mund t'i përgjigjet shpejt nevojave të tregut të punës në sektorë ku kërkohen aftësi të larta, ashtu dhe për vendet e origjinës pasi ato mund të kufizojnë efektet e largimit të trurit (brain drain). Për më tepër, Komunikata argumenton se promovimi i migracionit ciklik do të ketë efekte të dobishme për njerëzit e përfshirë pasi ato do të jenë në gjendje të kalojnë periudha të kufizuara kohe në B.E. dhe të fitojnë aftësi të reja, të përmirësojnë trajnimin dhe eksperiencën profesionale ose të fitojnë kapital monetarë shtesë.

I tërë koncepti është i bazuar në idenë e **një migracioni ciklik të rregulluar mire i cili është i monitoruar** si nga B.E. ashtu dhe nga vendi i origjinës dhe që përfshin gjithashtu stimuj të fortë për migrantë individual konform idesë së kthimit në vendin e tij/e saj kur koha e punimit/trajnitimit të saj/tij në B.E. ka përfunduar. Individët të cilët janë të përfshirë në migracionin ciklik dhe janë konform rregullave mund të përfitojnë nga procedurat e lehtësuar dhe të përsëritura të hyrjeve. Me fjalë të tjera, njerëzit që kanë qëndruar dhe punuar ose trajnuar në B.E. do ta kenë më të lehtë të kthehen përsëri në vendet e B.E. për arsye punësimi ose studimi me kusht që të kenë respektuar kriteret e migracionit ciklik. Komunikim parashikon gjithashtu skema për promovimin e ri-integritimit të shtetasve të vendeve të treta në vendet e origjinës pas qëndrimit në B.E.

Rekomandime Politike për përmirësimin e Kuadrit të B.E. në lidhje me nxitjen e Migracionit Ciklik

Rezultatet/Gjetjet e METOIKOS tregojnë se tipi i migracionit ciklik, siç është konceptuar deri tani nga korniza politike Evropiane e migracionit ciklik, është në një nivel të konsiderueshme jo-ekzistent. Ka shumë pak migrantë të kualifikuar të përfshirë në këtë lëvizshmëri ciklike të cilët mund të sjellin në vendin e origjinës aftësitë e fituara në B.E.. Në realitet, i vetmi migracion ciklik i rregulluar nga vendet anëtare të B.E. të studimit (Italia, Spania, Greqia, Hungaria, Polonia) është migracion sezonal në sektorin e bujqësisë.

Është e nevojshme që këto realitete të njihen nga Bashkimi Evropian dhe për pasojë duhet të miratohen masa speciale që ta kthejnë këtë lëvizje ciklike migratore nga spontane në të rregullt.

Në veçanti ne rekomandojmë që:

Komisioni Evropian të sigurojë **fonde dhe ekspertizë (know-how) për vendet e origjinës** në fqinjërinë e B.E. (për shembull Ukraina, Maroku, Shqipëria) në mënyrë që ata të **zhvillojnë politika të efektshme ri-integrimit për migrantët ciklik**. Në veçanti,

- **Të zhvillojnë skema krediti për kredi të vogla** që mund të nxisin zhvillimin e bizneseve të vogla p.sh në sektorin e bujqësisë, turizmit, hotelarisë ose të tregtisë në përgjithësi – sektorë në të cilët migrantët janë punësuar në vendin e destinacionit dhe kanë fituar një lloj eksperience.
- **Kufizimi i pengesave burokratike** dhe thjeshtimi i procedurave për ngritjen e një biznesi të vogël ose pajisja me licencë profesionale për të ndihmuar nxitjen e zhvillimit të biznesit nga migrantët ciklik të kthyer.
- Dhe natyrisht qëllimi i përgjithshëm i **ndërtimit të infrastrukturës** (energji, transport, telekomunikacione)

Komisioni Evropian duhet të krijojë një kornizë **stimujsh për Shtetet anëtare me qëllim që të ndihmojnë migrantët ciklik të fitojnë aftësi të reja**.

- **Kurse trajnimi të Gjuhës:** për të mësuar gjuhën e vendit të destinacionit. Kjo është vendimtare që përvoja e migracionit ciklik të çojë në akumulimin e kapitalit ekonomik dhe social.
- **Kurse trajnimi pune,** për shembull trajnimi i punëtorëve të kualifikuar ndërtimi, sigurimi i ekspertizës për zhvillimin e prodhimit bujqësorë, ose ndihma ndaj punëtorëve të pastrimit dhe përkujdesjes shtëpiake që të zhvillojnë kooperativa nëpërmjet të cilave të organizojnë punësimin ciklik.
- **Kurse ri-trajnimi** të cilat do të japin mundësinë e shfrytëzimit të aftësive të fituara (p.sh. infermieret ose doktorët Ukrainas të bëhen profesionistë të kualifikuar në Poloni)
- **Fonde/trajtime për sindikatat dhe institucionet e tjera të shoqërisë civile për të ngritur shërbime ndihmëse** për migrantët ciklik dhe kryesisht ata sezonal, veçanërisht sigurimi i informacionit në gjuhët që migrantët kuptojnë mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe ndihma ligjore falas për ata që përballen me situata punësimi abuzive.

Rekomandime mbi kategoritë e lejeve të qëndrimit dhe vizave që mund të lehtësojnë migracionin ciklik si dhe zhvillimi i dispozitave speciale të përkujdesjes sociale ose i skemave të bashkepunimit bilateral, mund të arrihen më mire vetëm në nivel të shteteve anëtare të B.E.. Prandaj, rekomandimet tona siç paraqiten më poshtë, i referohen vendeve specifike të destinacionit të përfshira në këtë studim: Greqia, Hungria, Italia, Polonia dhe Spanja.

Rekomandime Politke për politikbërësit Spanjollë në lidhje me Migracionin Ciklik midis Marokut dhe Spanjës

- **“Klauzola gjashtë mujore”** e cila pengon migrantët e rregullt të qëndrojnë më shumë se gjashtë muaj jashtë Spanjës, pasi rrezikojnë të humbin lejen e tyre të qëndrimit, **duhet të anulohet**. Kjo dispozitë është përfshirë në Rregullat e Implementimit të Ligjit për të Huajt në vitin 2000, një periudhë kur mungesa e fuqisë punëtore i kishte krijuar probleme serioze sipërmarrësve në disa sektorë dhe veçanërisht tek fermerët e zonës bujqësore të bregdetit të Mesdheut. Kjo dispozitë përbën pengesën kryesore të migracionit ciklik dhe është e pajustificueshme në një periudhë të papunësisë së lartë.
- Programet e migracionit të përkohshëm mund të përmirësojnë efektin mbi sistemin e përkujdesjes sociale të migrantëve dhe familjeve të tyre duke i siguruar atyre **informacion më të mirë dhe të plotë rreth të drejtave të tyre sociale**. Shpesh migrantët Marokenë të cilët janë të përfshirë në programet e migracionit të përkohshëm nuk njohin mundësinë e transferimit në Marok të benefiteve sociale që kanë fituar në Spanjë (si kontribues në Fondet e Sigurimeve Shoqërore).
- Niveli i ulët i kualifikimit të migrantëve Marokenëve në Spanjë, krahasuar me migracionin Maroken në vende të tjera Evropiane, ka disa efekte negative. Spanja duhet të **hartojë programe që të tërheqin studentë universitar Marokenë** duke i ofruar atyre bursa dhe mundësi të punojnë në Spanjë për disa vite pas përfundimit të studimeve, me kushtin që ata të kthehen në Marok më pas, ndërsa hyrja në tregun Spanjoll të punës duhet të hapet përsëri për to për periudha të shkurtëra kohe përgjatë jetës së tyre profesionale me qëllim që të rinovojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre ose të krijojnë rrjete profesionale ose afariste.
- Pasi kriza aktuale ekonomike të ketë mbaruar, duhet projektuar **një formë e re e qëndrimit të përkohshëm si përgjigje ndaj nevojave të sektorit të turizmit** e cila duhet t’i bashkangjitet ligjit të migracionit. Leja e përkohshme në fuqi është hartuar për të qenë funksionale në përputhje me nevojat e sektorit bujqësor, por nuk është e dobishme për fusha të tjera të ekonomisë. Turizmi, një aktivitet intensiv sezonal, mund të përfitojë nga migracioni ciklik nga Maroku në rast se kuadri ligjor do të ishte modifikuar.
- Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe ndihma zhvilluese e Spanjës drejt vendeve dërguese të migrantëve të Afrikës Perëndimore duhet të përqëndrohet më shumë në përpjekjet për **ndërtimin e institucioneve të afta për të ndërmjetësuar në tregun e punës**, pasi mungesa apo dobësia e tyre pengojnë menaxhimin e migracionit ciklik

Rekomandime Politike për Politikbërësit Italiane në lidhje me Migracionin Ciklik midis Marokut dhe Italisë

Politika e Migracionit dhe Integrimit

- Ulja e kufizimeve për kohën e shpenzuar jashtë vendit brenda periudhës së prezencës legale në Itali
- Adoptimi i vizës shumë-hyrëse e cila do të zgjasi për një numër të caktuar vitesh
- Skemat e sukseshme të migracionit ciklik kërkojnë nivel të lartë koordinimi midis punëdhënësve, shërbimeve të punës dhe administratës publike, stimuj për punëdhënësit për të punuar brenda sistemit (duke ju siguruar ardhja në kohë e punëtorëve kompetent, sigurimi i akomodimit për punëtorët në sektorin bujqësor), zbatimin e rregullave të migracionit dhe të tregut të punës dhe mbrojtja e të drejtave të punëtorëve migrantë. Është e këshillueshme të organizohen skema sektoriale të migracionit ciklik në bazë të provincave apo rajoneve.
- Lehtësimi i qasjes në statusin e qëndrimit afat gjatë dhe të nënshtetësisë së dyfishtë
- Mundësia e përfuturit nga shërbime speciale të migrantëve ciklik duke përfshirë këtu dhe sigurimin e mësimave shtesë për fëmijët që kanë humbur shkollën për arsye të mungesave jashtë vendit dhe organizimin e lëshimit me qira midis migrantëve ciklik me qëllim që të mbulojnë koston e qirasë ndërsa ndodhen jashtë vendit.

Tregu i punës dhe politikat sociale

- Sigurimi i trajnimit dhe i mbështetjes për përmirësimin e mundësive të ngritjes në karrierën profesionale me qëllim që të lehtësohen qarkullimi i trurit (brain circulation) dhe i investimeve në Marok.
- Stimulimi i vetë-punësimit dhe i krijimit të biznesit, masa të cilat mund të shtojnë gjithashtu nivelet e qarkullimit/ciklimit ekonomik.
- Zbatimi i rregullave ligjore në tregun e punës në kontrast me ekonominë e madhe jo formale është një *sine qua non* e skemave efektive të migracionit ciklik.
- Një marrëveshje e sigurimeve sociale midis Italisë dhe Marokut për lejimin e totalizimit të kontributit të bërë në të dy vendet mund të jetë gjithashtu një nxitje për migrimin ciklik afat gjatë.

Politikat dhe praktikat Marokene ndaj shtetasve Marokenë me banim jashtë vendit

- Qeveria Marokene duhet të përpiqet të sigurojë mbështetje investuese specifike ndaj shtetasve Marokenë me banim jashtë vendit, në veçanti, përpjekje duhen bërë për lehtësimin e mbështetjes ndaj investitorëve dhe grupeve të vogla investitore.
- Udhëzimet në Arabisht konsiderohen tepër të rëndësishme për ruajtjen e lidhjeve me Marokun dhe e qarkullimeve ciklike sidomos tek brezi i dytë dhe duhet të vazhdojë të mbështetet nga institucionet Marokene.
- Autoritetet Marokene duhet të heqin pengesat ndaj migrantëve ciklik si gjoha për makinat me targa të huaja që qarkullojnë në Marok për tre muaj ose më shumë.

Rekomandime Politike për Politikbërësit Italiane në lidhje me Migracionin Ciklik midis Shqipërisë dhe Italisë

Rezultatet/Gjetjet e projektit METOIKOS sugjerojnë se situata aktuale e migracionit Shqiptarë në Itali mund të përmirësohet ndjeshëm nëpërmjet sigurimit të perspektivës të punësimit në Itali për migrantët potencial Shqiptarë, të promovimit të migracionit ciklik midis Italisë dhe Shqipërisë dhe të kthimit në Shqipëri, dhe së fundi ofrimin e informacionit të saktë rreth mundësive dhe pengesave të migrimit të ligjshëm në Itali. Pikat e mëposhtme përbëjnë tregues më specifik përsa i përket masave politike që duhen marrë në këtë drejtim.

Për sa i përket **Kontekstit Politik Italian:**

- **Dhënia e mundësisë të konvertimit të lejes sezonale të qëndrimit/punës në vjeçare, dy-vjeçare dhe pesë-vjeçare, procedurë që mund të japi mundësinë e aplikimit për shtetësinë Italiane.**
- **Tarifa më të ulëta të lejeve të punës, veçanërisht për punëtorët sezonal.**
- **Lehtësimi dhe pajisja e shpejtë me leje pune/qëndrimi dhe thjeshtëzimi i procedurave burokratike përkatëse.**
- **Pjesëmarrja e plotë e Shqipërisë në sistemin e të drejtave dhe shanseve të B.E.-së mund të jetë rruga më e mire për të gjithë palët e përfshira në mënyrë që të përfitohet nga potenciali socialo-ekonomik dhe kulturor i ngulitur tashmë në eksperiencën e migracionit Shqiptarë.**
- **Futja e instrumenteve krijues dhe fleksibël, si ‘viza e punë-kërkuesit’ e cila mund të kombinojë potencialin migrator të popullsisë Shqiptare me rritjen e fleksibilitetit të ekonomisë Italiane mbi termat e një avantazhi reciprok.**
- **Mbështetja e shoqatave Shqiptare për zhvillimin e shërbimeve për migrantët Shqiptarë, përfshirë këtu: shpërndarjen e informacionit në lidhje me kërkesat ligjore dhe mundësitë e punësimit/rregullimit, dhe zhvillimin e iniciativave për zhvillimin e sensit kritike të përkatësisë si migrantë Shqiptarë në Itali dhe si shtetas shqiptar për të kthyerit në Shqipëri.**
- **Trajnimi i të kthyerve potencial mbi hapjen dhe menaxhimin e një kompanie tregtare dhe informimi i tyre rreth mundësive aktuale që ofron Shqipëria në fushën e kredive, të qëndrueshmërisë së tregut dhe të infrastrukturës.**

Për sa i përket **Kontekstit Politik Shqiptarë:**

- **Trajnimi i migrantëve të kthyer mbi shanset e punësimit dhe të shërbimeve në dispozicionin e tyre, përfshirë këtu dhe krijimin e ndërmarrjeve të reja ekonomike.** Shërbimet e ofruara nga sportelet e migracionit pranë zyrave të punës duhet të bëhen më specifike, të efektshme dhe individuale, por konsiderohet e nevojshme gjithashtu funksionimi i qëndrave informacioni/trajnimi të subvencionuara nga shteti.
- **Zhvillimi i infrastrukturave kyc si: disponimi i energjisë së rregullt elektrike dhe i ujit të pijshëm dhe i rrjetit rrugor/hekurudhor/portual.**
- **Mbështetja ndaj qeverisë Shqiptare dhe OJQ-ve në luftën kundër korrupsionit dhe drejt zhvillimit të një sistemi politik më pak konfliktual dhe të polarizuar.**
- **Thjeshtëzimi i procedurave burokratike në lidhje me të kthyerit, duke patur si reference të veçantë ngritjen e ndërmarrjeve të reja ekonomike.**
- **Inkurajimi i migrantëve të kthyer që duan të hapin biznesin e tyre nëpërmjet lehtësimit të qasjes tek kreditë, të trajnimit strategjik dhe të reduktimit të taksave.** Kjo mund të përfshijë reduktimin e taksave për kompanitë e eksport-importit që operojnë midis Shqipërisë dhe Italisë, të cilat janë ndikuar veçanërisht nga kriza ekonomike.

Rezultatet/Gjetjet kryesore të studimit dhe rekomandimet politike mbi migracionin ciklik midis Shqipërisë dhe Greqisë

Tipat e migracionit ciklik të identifikuar

4 tipa/kategori të migrantëve ekonomikë ciklik janë identifikuar nga ky studim:

- Punëtorët sezonal të ligjshëm në bujqësi (metaklisi),
- Punëtorët sezonal të paligjshëm (në bujqësi dhe ndërtim),
- Migrantët e ligjshëm me leje qëndrimi 2-vjeçare ose 10-vjeçare të cilët në Greqi bëjnë punë të pakualifikuara (zakonisht punojnë në sektorin e ndërtimit) dhe në Shqipëri punojnë si punëtor të pakualifikuara ose drejtojnë një biznesë të vogël,
- Migracioni i ligjshëm ciklik i njerëzve me kualifikim të mesëm ose të lartë dhe me një status qëndrimi të sigurtë në Greqi dhe që në Shqipëri janë të punësuar në punë të kualifikimit të lartë ose menaxhojnë biznesin e tyre.

Migrantët ciklik që mbartin më shumë kapital në vendin e tyre të origjinës janë migrantët e ligjshëm që lëvizin spontanisht midis dy shteteve (lloji 2). Migrantët e ligjshëm sezonal që shkojnë për të punuar në kuadrin e marrëveshjes bilaterale të punësimit sezonal për 6 muaj çdo vit (dhe pastaj kthehen përsëri në Shqipëri, lloji 1) i karakterizon, në përgjithësi, modeli i konsumit sipas nevojave të mbijetesës dhe jo i investimeve nga momenti që ata kthehen në Shqipëri. Në këtë kontekst, cila mund të jetë vlera shtesë e një marrëveshjeje të re punësimi midis dy vendeve? Studimi METOIKOS sugjeron marrjen e masave konkrete nga të dy vendet gjë që eventualisht mund të bëjë të mundur sjelljen e objektivave politike më afër realitetit, shanseve dhe problemeve të krijuara nga kjo lëvizje njerëzish dhe kapitali. Për më tepër, ky diskutim bëhet i domosdoshëm në kuadrin e krizës ekonomike ku numri i migrantëve ciklik spontan ka të ngjarë të rritet, të nivelit të integritimit të tyre në tregun lokal të punës dhe në shoqërinë Greke, të afërsisë gjeografike me Shqipërinë dhe të liberalizimit të vizave Schengen - megjithëse është ndoshta shumë herët të vlerësojmë impaktin e këtij të fundit.

Mesazhet Kyç për Politikbërësit Grek

1. Punëtorët sezonalë sipas dispozitave të ftesës afatshkurtër (*metaklisi*) disponojnë sigurime sociale (vetëm përkujdesjen shëndetsore) të paguar nga punëdhënësi i cili i ka ftuar, por që praktikisht ata nuk mund t'a përdorin atë.

Në këtë kontekst, ne sugjerojmë:

- Ndryshimin e ligjit me qëllim që migranti i ftuar me metaklisi të pajiset me librezën e shëndetit nga OGA, menjëherë pas 3 muajve të ardhjes së tij në Greqi dhe pasi disponon vërtetimin (veveosi) ose lejen e përkohshme të qëndrimit.
- Regjistrimi i të drejtave të pensionit të këtyre punëtorëve migrantë në arshivën përkatëse të Ministrisë së Brendshme. Pagesa e pensionit duhet të kryhet direkt nga migranti (në përqindje më të madhe) dhe indirekt (në një përqindje më të vogël) pas një reduktimi ekuivalent të shumës së taksave të kthyera që ai merr nga punëdhënësi.

2. Në kuadrin e krizës ekonomike, migracioni ciklik në Greqi pritet të jetë në ngritje. Rrjetet e migrantëve Shqipëtarë në tregun lokal të punës, afërsia gjeografike me Shqipërinë dhe liberalizimi i vizave përbëjnë faktorë shtesë që e vërtetojnë këtë argument. **Në këtë kontekst, rinovimi i lejeve të qëndrimit mund të perceptohet si mbajtja e një dëre hapur drejt Greqisë. Për më tepër, kjo do të thotë se të ardhurat e siguruar nga sigurimet shoqërore nuk do të humbasin.** Kjo është një çështje që nuk prek vetëm migrantët ciklik por edhe migrantët me qëndrim permanent në rast se të shtyrë nga papunësia në Greqi duan të kthehen gjithashtu në Shqipëri. Duke patur parasysh vështirësitë e rinovimit të lejeve të qëndrimit ne sugjerojmë:

- Reduktimin i pullave të sigurimeve shoqërore dhe ndryshimi i mënyrës se si kontributi i sigurimeve shoqërore paguhet për të gjitha kategoritë e punësimit në vartësi. Punëdhënësi, për shembull, paguan 50% të pullave të sigurimeve shoqërore dhe pjesa tjetër paguhet nga migranti. Punëdhënësit pasi deklarojnë punësimin e shtetasve të vendeve të treta, le t'ju jepet mundësia të përfitojnë një ulje të nivelit 7-10% të kostos së sigurimeve shoqërore, e cila mund të mbulohet nga vetë shteti. Migranti mund të nevojitet të paguaj vetëm për përkujdesjen e tij shëndetsore. Ndërkaq, pagimi i kontributit për pensioni mund të jetë fakultativ.
3. **Marrëveshje bilaterale** për transferimin e të drejtave të pensionit, për transfertë parash, për heqjen e transfertave (në raste specifike), monitorimi i mekanizmave për operimin e zyrave doganore janë disa nga masat e tjera që duhet të merren.

Rekomandime për Politikbërësit Shqiptarë

Problemi kryesor për ri-integrimin e Shqiptarëve të kthyer dhe/ose migrantëve ciklikë konsiston në faktin se ata nuk ndihmohen nga autoritetet lokale me informacionin përkatës në lidhje me çfarë të investojnë dhe ku.

Një zhvillim pozitiv nga ana e Shtetit Shqiptarë është funksionimi i sporteleve të migracionit në disa zona dhe i zyrave lokale të punës. Megjithatë, ekzistenca e tyre është pothuajse e panjohur dhe mungojnë objektivat e mirëinformuara dhe të adaptueshme konkrete politike. Si pasojë, ato nuk arrijnë të ofrojnë shërbime këshillimi për orientimin në tregun e punës, i cili përbën faktor vendimtarë për funksionimin e tyre. Në kuadrin e funksionimit të mekanizmave të zyrave të punës ne sugjerojmë:

- Ngritjen e një mekanizmi informues dhe referent në dispozicion të shërbimeve publike
- Forcimi i rolit të Zyrëve së Punës a) duke i ofruar konsulentëve të Zyrave të Punës ekspertizë të pasur në vartësi të tregut lokal ekzistent të punës, të zonës dhe potencialit të saj për zhvillim, dhe b) duke organizuar fushata lokale për rritjen e ndërgjegjësimit duke filluar që nga bangat e shkollave e akoma më lart.

Proçedurat e këshillimi në lidhje me orientimin në tregun e punës duhet gjithashtu të marrin parasysh aftësitë e ndryshme si dhe eksperiencën profesionale që Shqiptarët e kthyer nga migrimi kanë fituar jashtë vendit. Kjo mund të arrihet horizontalisht nëpërmjet anketave/sondazheve lokale që do të pasurojnë njohuritë mbi nivelin arsimor të popullsisë lokale dhe modelet e investimeve; dhe vertikalisht, nëpërmjet stimujve që i jepen migrantëve të kthyer të ndajnë (akoma dhe të shesin) eksperiencën profesionale të fituar jashtë. Agjencia e re e krijuar në Shqipëri AIDA – Agjencia Kombëtare e Investimeve mund të kontribuojë por dhe të përfitojë nga skema të tilla trajnimi mbi investimet lokale.

Problemet e ri-integrimit padyshim që i kapërcejnë kufijtë e kompetencave të Zyrave Rajonale të Punës dhe të Sporteleve të Migracionit, pasi ato reflektojnë kryesisht karakteristikat strukturore të tregut Shqiptarë të punës. Në këtë kuadër, ne sugjerojmë marrjen e iniciativave të mëposhtme:

- **Lehtësimi i aksesit në tregun e kredive kompetitive** për migrantët e kthyer dhe ciklik me qëllim që të investojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë Shqiptare.
- **Stazhi i punës në firma të mesme dhe të vogla** konsiderohet praktikë pozitive që është aplikuar nga shoqata dhe OJQ si pjesë e paketës mbështetëse drejt hapjes së biznesit.
- Ofrimi i stimujve ekonomik për investimet e migrantëve të kthyer, të cilat mund të marrin formën e **lehtësimeve burokratike për hapjen e biznesit, e reduktimit të taksave për periudhën fillestare të kthimit.**
- Sektori rural/bujqësorë përbën variabël kyç drejt zhbllokimit të potencialit zhvillues të vendit. Pjesa më e madhe e migrantëve të kthyer dhe ciklik janë mbajtës të një kapitali të vogël financiar të investuar tashmë në bujqësi. Ata duhet mbështetur me **infrastrukturën bazë si rrugë dhe ujë për sektorin bujqësorë dhe investime të tjera relative si (agro-) turizmi.**
- Përveç kësaj, problemet e mungesës së **infrastrukturës në sistemin arsimor në të gjithë vendin** duhen përballuar pasi përbëjnë faktor dekurajues si për kthimin e migrantëve Shqiptarë ashtu dhe për ata migrantë të kthyer që duan të qëndrojnë dhe të investojnë në Shqipëri.

Rekomandime Politike per Politikbërësit Polak në lidhje me Migracionin Ciklik midis Ukrainës dhe Polonisë

Ideja e migracionit ciklik duke ideale për fuqinë punëtore vendase që të mbushi boshllëkun në disa sektorë. Gjithsesi, mbi migrantët mund të abuzohet nga persona ose nga agjenci të sektorit të punësimit të përkoshëm në lidhje me pagesat, siguracionet sociale dhe orët e punës. Prandaj, është e nevojshme të hartohen politika që parandalojnë shfrytëzimin e punëtorëve migrantë. Rekomandimet që duhet të merren parasysh përfshijnë:

- Ngritja e një strukture/zyre/organizmi për qëllimin e qartë të lidhjes së punëtorëve me punëdhënësit. Kjo strukturë mund të organizojë panairë pune në Ukrainë për të inkurajuar punësimin e ligjshëm e punëtorëve migrantë. Struktura mund të shërbejë gjithashtu për të asistuar punëtorëve migrantë që ndohen në Poloni për të gjetur strehim, për tu siguruar, mësimin e gjuhës dhe shërbime të tjera si përkthime të CV'Ve, etj. Për më tepër, kjo strukturë mund të jetë përgjegjëse për respektimin e të drejtave të migrantëve, si dhe për përmbushjen e përgjegjësisë të punëdhënësve ndaj punëtorëve. Në rastet e abuzimeve, migrantët mund të mundësohen t'i kthehen kësaj strukture për asistencë ligjore.
- Dikush duhet të kuptojë se migracioni midis Polonisë dhe Ukrainës është zhvilluar si një formë e vetë-organizimit të shoqërisë dhe ishte kryesisht spontane. Migrantët Ukrainas gjejnë punë në vendet e huaja nëpërmjet shokëve të tyre, dhe i qasen direct punëdhënësve të huaj. Prandaj, migrantët ciklik duhet të ndihmone nga migrantët të tjerë Ukrainas, të cilët janë me qëndrim në Poloni ose të cilët kanë mbaruar studimet universitare në Poloni. Ato përbëjnë një kapital të konsiderueshëm social. Organizatat e krijuara prej tyre, nganjëherë spontanisht e ndonjëherë jozyrtarisht janë shumë më të besueshme tek migrantët se sa çdo OJQ Polake ose institucione zyrtare.
- Rastet e abuzimeve nga ana e punëdhënësve, sidomos në sektorin e ndërtimit por edhe keqtrajtrimet e vëna re në sektorin bujqësor, të shërbimeve shtëpijake dhe industri vërtetojnë se aktivitetet publike adresuar kësaj nënkategorie migrantësh duhet të përqëndrohen në dhënien e informacioneve në lidhje me rregullat e parashikuara nga ligji Polak i punës dhe kushtet e punës, si dhe asistencë ligjore falas, sidomos në Ukrainisht dhe Rusisht. Aktivitetet e mësipërme duhet të ndërmerren nga të dy palët, pra si nga vendi pranues ashtu edhe ai dërgues, rrjedhimisht kjo kërkon bashkëpunim bilateral.
- Duke marrë në konsideratë faktin se gjuha përbën faktorin themelor të integritimit dhe të qasjes në informacion, ne propozojmë funksionimin e kurseve të gjuhës në Poloni si një element konstant i sistemit të integritimit. Duket se kurset e gjuhës duhet të organizohen nga bashkitë dhe të financohen nga buxheti qëndror. Ato duhet të mbulojnë të paktën elementë bazë si leximi dhe shkrimi në alfabetin Latin.
- Ne duhet të tërheqim vëmendjen tek fakti se grate migrante janë më të ekspozuara ndaj marginalizimit social, pasi ato shpesh janë të punësuar ilegalisht, shpesh në sektorin e përkujdesjes private, e cila nuk e favorizon integritimin. Gratë migrante gjithnjë e më shpesh bëjnë punë të cilat janë kyç për familjen Polake, punë shpesh të padukshme. Masa speciale janë të nevojshme për promovimin e integritimit të tyre në shoqërinë Polake.
- Jo të gjithë migrantët janë të interesuar në pasjen e një marrëdhënieje formale pune. Gjithsesi, rezultatet e studimit tone sugjerojnë se siguri i lëvishmërisë së benefiteve si pensionet, mund të inkurajojnë si formalizimin e marrëdhënieve të punësimit ashtu dhe kthimin e migrantëve në Ukrainë.

Migrantët ciklik të studimit tone, vunë në dukje gjithashtu aspektet e mëposhtme që ata dëshirojnë t'i shohin të adresuara:

- Zhvillimi i shërbimeve më të lira për tranfektën e parave drejt Ukrainës
- Lehtësimi dhe fleksibiliteti i vizave për punë me qëllim që migrantët të mundësohen të ndalojnë qëndrimin e tejkzatur në Poloni, kur ato e kanë të nevojshme ose në të kundërt të qëndrojnë më gjatë nëse dëshirojnë

Rekomandime Politike per Politikbërësit Hungarez në lidhje me Migracionin Ciklik midis Ukrainës dhe Hungarisë

Pasi Hungaria ka përballuar një nga krizat ekonomike më të forta (midis vendeve të B.E.) dhe niveli i tregut të punës Hungarez ka rënë, një vëmendje më e madhe i duhet kushtuar **ofrimit të informacionit përkatës mbi funksionimin e tregut Hungarez të punës** migrantëve potencial në Ukrainë (veçanërisht për Ukrainasit me origjinë Hungareze të cilët implikohen më thjesht në migracionin ciklik). Kjo është e rëndësishme për t'ju shmangur zhgënjimeve dhe shfrytëzimeve të migrantëve (me pagë shume të ulët) në Hungari, faktorë që ndikojnë negativisht mbi migracionin ciklik.

Pasi **ligjet rreth lëvizshmërisë (në lidhje me punësimin sezonal, vizat dhe procedurat e aplikimeve për natyralizimin/nënshtetësinë) ndërrojnë shume shpesh**, është e vështirë për migrantët, por disa here edhe për burokratët e administratës publike, të mbajnë nën kontroll situatën. Të natyralizuar ose jo migrantët Hungaro-Ukrainas janë ekspozuar përballë situatave të ndryshme në lidhje me lëvizshmërinë, kushtet e punës (për shembull në lidhje me pagesën) dhe rregullat burokratike të kalimit të kufirit drejt Hungarisë. Në të vërtetë, Hungarezët e natyralizuar përballojnë më pak fenomene ksenofobike, kurse Hungarezët e pa natyralizuar të Ukrainës shihen si të huaj (sipas ligjit ata janë të huaj) dhe përballojnë vështirësi të natyrës burokratike dhe ligjore (shume shpesh pagat janë të pa barabarta) në Hungari dhe pengesa në kalimin e kufijve. Kjo çon në pakënaqësi duke krijuar tensione midis grupeve të migrantëve. Pengesat në kufij dhe eskperienca e diskriminimit në tregun e punës funksion në dëm të lëvizjeve/migracionit ciklik.

Pasi migracioni ciklik dhe integrimi nuk janë fenomene kontradiktore midis tyre, është e rëndësishme të krijohen **më shumë mundësi për punësim sezonal të ligjshëm** (siç ndodh në rastin e Polonisë për shembull). Kjo duhet të shoqërohet gjithashtu me procedura lehtësuese në kufi. Rradhët e gjata dhe kontrollet e ashpëra dekurajojnë njerëzit të udhëtojnë/qarkullojnë, dhe njëkohësisht bëjnë integrimin e tyre si në Ukrainë ashtu dhe në Hungari mjaft të vështirë.

Sigurimi i ndihmës për krijimin e Kompanive me Përgjegjësi të Kufizuara në Hungari

Nga momenti që hyrja në Hungari pas Marrëveshjes Shengen u bë më e vështirë, ligji mbi krijimin e Kompanive me Përgjegjësi të Kufizuara e uli shumë e parashikuar për funksionimin e tyre nga 3 Milion HUF në 500.000 HUF, fakt që solli si pasojë hapjen e kompanive të tilla nga migrantë ciklik Ukrainas. Kjo u kthye në një praktikë të rëndësishme për të përfituar leje pune, pasi diçka e tillë është e domosdoshme për pajisjen më tej me leje qëndrimi.

Studimi jonë në terren tregoi se migrantët ciklik nga Ukraina (si dhe migrantë të tjerë në Hungari) ndeshen shumë shpesh problemin e gjetjes së strehimit të përshtatshëm në Hungari. Ofrimi i shërbimeve në gjetjen e strehimit dhe në thjeshtësimin e procedurave - si krijimi i zyrave speciale për strehim, do të lehtësonte procedurën e marrjes me qira të një shtëpie.

Për të lehtësuar lëvizjet ciklike të shtetasve të huaj në Hungari mund të ishte e rëndësishme:

- Nxitja e sindikatave dhe e OJQ-ve të monitorojnë dhe të kërkojnë trajtim të barabartë në tregun e punës. Kjo do të inkurajonte Ukrainas dhe Hungarezë të Ukrainës të implikohen më shumë në migracionin ciklik.
- Karta biometrike për lëvizjet lokale ndërmjet kufijve funksionon si pengesë për qarkullimin ciklik. Mënyra alternative duhet të merren në konsideratë.
- Më shumë vëmendje i duhet kushtuar pasojave të krijuara nga mospërputhja e kushteve reale ekonomike dhe e rregullave të aplikuara ndaj migrantëve me origjinë hungareze si dhe debatit mbi “Hungarezët jashtë shtetit”, “Hungarezët nga pellgu i Karpateve”, etj. Hungarezët etnikë nga vendet fqinje (veçanërisht nga Ukraina) pranohen shpesh ose si forcë e lirë punëtore ose trajtohen si të huaj të padëshiruar dhe të rrezikshëm. Ky trajtim është në kundërshtim të plotë me retorikat e “Hungarezëve jashtë shtetit” si dhe tendencat e migrantëve Hungarezo-Ukrainas të mospërfillin diferencën midis origjinës etnike dhe nacionalitetit. Këto

mospërputhje sjellin si pasojë zhvillimin e racizmit dhe të ksenofobisë si në Hungari ashtu edhe në Ukrainë. Për këtë arsye është e rëndësishme:

- të minimizohet influenca e mitit të territoreve të humbura Hungareze dhe të minoriteteve Hungareze në shtetet fqinje.
- Të ofrohen kushte për një trajtim më të mirë të “Ukrainasve” në Hungari.

Megjithëse, Ukrainasit Hungarezë të përfshirë në migracionin ciklik midis Hungarisë dhe Ukrainës janë më të shumtë, gjithsesi ky grup ka tendencë të migrojë në formë ciklike drejt destinacioneve të tjera (me kushte më të përshtatshme). Nga një prizëm afatgjatë, do të ishte më e këshillueshme të **organizohen dhe t’i ofrohen shërbime migrantëve jo Hungarezë nga Ukraina në Hungari, si asistencë gjuhësore dhe shërbime ligjore**, (për migrantë/refugjatët nga shtete jo Evropiane të cilat janë subjekte të ligjeve të BE-Hungarisë-Ukrainës dhe e marrëveshjeve respektive). Për këto të fundit, veçanërisht, është e rëndësishme ti jepet informacioni i duhur ligjor dhe këshillim në kufij sipas marrëveshjes të ripranimit me qëllim që ti shmangen dëbimeve/deportimeve.

Ligji i ri për shtetësinë në Hungari (i pranuar në Janar 2011) ka rezultuar në paqartësi ligjore dhe ka krijuar shqetësime për Shtetin Ukrainas. Për ato Ukraians që janë të interesuar për të marrë shtetësinë Hungareze, duket se përbën një procedure të komplikuar dhe të shtrenjtë. **Është e rëndësishme të ofrohen alternative më pak të komplikuar (se sa të marrin shtetësinë Hungareze) duke thjeshtëzuar procedurat e migracionit të ligjshëm nga Ukraina në Hungari si dhe lehtësimin e procesit.** Për këtë arsye është e rëndësishme të:

- Sigurohet më shumë asistencë për marrjen e shtetësisë (përfshirë dhe ndihmën financiare për përkthimet) dhe për lehtësimin e procesit.
- Sigurohen më shumë mundësi për punësim të ligjshëm në Hungari (kryesisht për punësim sezonal si në rastin e Polonisë) pa nevojën e marrjes së shtetësisë.



Robert Schuman Centre for Advanced Studies